



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i buxhetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Rrahman Rraja, Dritan Bici, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Blendi Klosi - Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Adrian Kamenica - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit

Vilma Kola - Përgjegjëse e Buxhetit në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit

Shpresa Mezini – Këshilltare e ministrit

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Sipas axhendës intensive të kësaj jave, vazhdojmë sot me takimin e fundit për diskutimin e projektbuxhetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Relator është zoti Baraj. Të ftuar kemi zotin Klosi, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit, zonjën Ornela Çuçi, zëvendësministre, zotin Adrian Kamenica, sekretar i Përgjithshëm, zonjën Vilma Kola, përgjegjëse e Buxhetit dhe zonjën Shpresa Mezini, këshilltare. Mirë se keni ardhur në komision!

Zoti Baraj, si fillim do ia japim fjalën ministrit për të prezantuar buxhetin, më pas do të vazhdojmë me pyetjet e kolegëve dhe në fund me komente, sugjerime apo vërejtje.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Dakord.

Zoti Klosi, fjala është për ju.

Blendi Klosi - Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në cilësinë e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, së bashku me stafin drejtues të ministrisë, do të doja të shprehja me pak fjalë përgëzimin për punën e bërë gjatë këtij viti nga komisioni juaj për disa pika të rëndësishme që ne kemi diskutuar dhe, po ashtu, për mbështetjen nga ana juaj të politikave që ka ndërmarrë ministria. Kjo gjë na bën të mendojmë që në të dy sektorët, mjedis dhe turizëm, ne të jemi në një situatë shumë më pozitive sesa një vit më parë kur ishim në këtë komision.

Ne kemi pasur aleancë të madhe me të gjitha institucionet shtetërore dhe me pushtetin lokal, por falë kontributit të komisionit tuaj dhe të politikave të ndjekura nga qeveria e Kryeministrit Edi Rama dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ne sot vijmë me një situatë shumë më pozitive në të dy sektorët.

E them këtë, sepse viti që po mbyllim nga pikëpamja buxhetore apo viti që po hap përpyjekjet për vitin 2019, ka qenë i mbushur me diskutime për turizmin dhe mjedisin. Nuk i kanë munguar jo vetëm ligjet që kemi miratuar në parlament, politikat e reja fiskale dhe përpyjekjet për të ndërtuar një situatë krejt tjetër në kuadër të menaxhimit të territorit nga pikëpamja mjedisore, por ka qenë i mbushur me operacione të thella të pastrimit jo vetëm sipërfaqësor, të pastrimit nga papastërtitë, por më shumë se kaq. Në vitin që po mbyllim dhe që janë premisat për buxhetin e ri apo për vitin e ri administrativ, ne kemi arritur të realizojmë një sërë paketash, që ne i kemi quajtur brenda operacionit “*clean and green*

2020”, i cili ka kërkuar që, për sa i përket pastrimit, ne të shkojmë në eliminimin e shumë shkaqeve që sjellin papastërti në Shqipëri.

Ne vazhdojmë të shprehim bindjen se Shqipëria nuk është e ndotur, Shqipëria është e papastër dhe për të eliminuar këtë papastërti ne kemi nevojë që, edhe nëpërmjet politikave që paraqet buxheti i ri, të shikojmë në kuadër të operacionit tonë *clean and green* për më shumë struktura në realizimin e kësaj filozofie.

Të nderuar kolegë deputetë, për sa i përket turizmit, unë vij në këtë analizë të projektbuxhetit të ri nga një institucion që gjatë vitit 2018 ka pasur mundësi të shënojë rritjen më të madhe të numrit të turistëve në krahasim me vitet e tjera, por edhe të trendit rritës. Kjo vjen jo si një arritje e vitit të fundit, por si një arritje e politikave të pesë viteve të ndjekura nga qeveria e Edi Ramës. Sot kemi arritur të flasim për një turizëm të qëndrueshëm dhe të kërkojmë nëpërmjet buxhetit të ri disa elemente shtesë për ta përdorur këtë turizëm të qëndrueshëm jo vetëm për të rritur numrin e turistëve që vijnë në Shqipëri, por për ta shndërruar Shqipërinë në një destinacion turistik europian.

Viti 2018 shënoi rritje të numrit të turistëve me 20% më shumë nga viti 2017. Ne presim që në Shqipëri të vijnë rreth 6 milionë turistë të huaj (të jeni të sigurt që këtë shifër do ta arrijmë), prandaj mund të themi që gjatë vitit 2018 buxhetit të shtetit i kemi sjellë rreth 2 miliardë euro, nga të cilat mbi 300 milionë kanë qenë fitim i drejtpërdrejt ose të shtuara më shumë sesa viti 2017.

Nëse flasim për sektorin e turizmit, rritjet janë relativisht shumë të mëdha. Kjo pasqyrohet edhe në projektbuxhetin e vitit tjetër. Një sektor që ka prodhuar kaq shumë të ardhura për ekonominë familjare shqiptare dhe jo vetëm për një zë të buxhetit, padyshim ka vëmendjen më të rritur edhe në vitin e ardhshëm.

Kjo shprehet në dy faktorë:

Së pari, në investime direkte që ne marrim nga buxheti i ri në sektorin e turizmit, të cilat kanë të bëjnë më shumë me politikat dhe marketingun e destinacionit turistik shqiptar, përgatitjen për herë të parë të planeve të menaxhimit turistik të zonave me përparësi zhvillimi turizmin, që e zë buxheti i ri, me përgatitjen e hartave dhe të filozofisë së ndërtimit të zonave të mbrojtura apo zonave që mund të shndërrohen nga zona të mbrojtura natyrore në zona të mbrojtura natyrore me një vizitim më të mirë nga turistët shqiptarë dhe të huaj, të kemi mundësi që me politikat e reja të paraqitura edhe në buxhetin e ri të shtojmë investimet në fushën e turizmit. Po ashtu, të vazhdojmë politikat tona, që kanë të bëjnë me shndërrimin e Shqipërisë në destinacion turistik alternativ me qëllim që të mos kemi vetëm detin si opsion turistik, por të kemi nxitje më shumë të investimeve në dy projektet e mëdha, që qeveria

shqiptare ka promovuar kaq shumë gjatë vitit 2018, si politikat e 100 fshatrave, ashtu edhe politikat e agroturizmit.

Pra, ne mendojmë se sektori i turizmit duhet të marrë më shumë para nga pikëpamja e politikave dhe marketingut, promovimit dhe vendosjes së rregullave në sektorin e turizmit, por nëse do të ngeleshim këtu, do të ishim krejtësisht të pakënaqur. Po të shikojmë investimet e mëdha, që ju, të nderuar kolegë deputetë, i keni parë, në sektorët që ndikojnë drejtpërdrejt në turizëm, duke filluar nga sektori më i rëndësishëm, infrastruktura, që ka një rritje të madhe në buxhet dhe që shkojnë paratë ...

Nëse vjet folëm për fillimet e projektit 1 miliard, sivjet kemi investime konkrete, të cilat janë në fazën e përgatitjes dhe të implementimit. Janë rrugë, të cilat po realizohen konkretisht. Falë implementimit në terren të projektit të Bankës Botërore dhe Bankës Europiane për Zhvillim, në buxhetin e këtij viti ne kemi një listë të plotë të rrugëve që çojnë më shumë në zhvillimin turistik, por më shumë se kaq, do të kemi edhe vazhdim me ritme shumë të shpejta dhe shumë pozitive për sa i përket infrastrukturës së madhe, duke menduar që viti 2019, përveç investimeve në autostrada dhe rrugët lidhëse, do të shënojë investime të konsiderueshme edhe në infrastrukturën aeroportuale.

Pra, mendojmë që vendosja në funksionim e aeroportit të Kukësit dhe hapja e negociatave dhe fillimi i punimeve për aeroportin e Vlorës dhe mundësisht edhe atë të Sarandës, do të shënojë investimin më të madh të ndodhur ndonjëherë në fushën e turizmit.

Politikat dhe investimet në infrastrukturë po marrin në buxhetin e këtij viti një vëmendje super të konsiderueshme. Po të shtojmë edhe politikat e ndjekura nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për arsimin profesional, për shtimin e kapaciteteve në trajnim të shërbyesve në sektorin e turizmit, po të konsiderojmë numrin e kërkesave gjithmonë në rritje, ky është një debat që nuk ka fund në politikat tona. Gjithmonë e më shumë duhet të marrim vëmendje për shtimin e kapaciteteve, jo vetëm të shkollave profesionale, por edhe të qendrave të formimit profesional. Sektori i turizmit ka sot kërkesë për të paktën dhjetëfishin e atyre që ne kemi në arsimin profesional. Pra, ne duhet ta vazhdojmë këtë dimension dhe ta thellojmë nxitjen e programeve. Në politikat tona të turizmit dhe në buxhetin e vitit 2019 një nga politikat e ndjekura është shtimi i hapësirave për më shumë trajnim dhe për më shumë kapacitete në këto investime.

Të nderuar kolegë deputetë, për sa i përket sektorit të turizmit, Ministria e Turizmit, së bashku me kompanitë që sjellin turistë në Shqipëri dhe ata që bëjnë menaxhimin e numrit të turistëve brenda dhe jashtë vendit, me komunitetin e investitorëve të drejtpërdrejtë në hoteleri dhe në struktura akomoduese dhe me institucionet që janë pjesë e pandarë e

politikave të ministrisë, kemi lançuar planin e veprimit, që ne e kemi quajtur “sfida 10 milionë” apo “sfida e 365 aksioneve të ndërmarra gjatë gjithë vitit”, për të arritur 10 milionë turistë në vitet e para të dekadës së re. Detyrat e realizuara nga institucionet së bashku me partnerët për 365 masa për ta shndërruar Shqipërinë në destinacion turistik 365 ditor, padyshim që kanë nevojë për buxhet.

Në qoftë se do të prisnim që ky buxhet të ishte vetëm në një zë të buxhetit të shtetit, kjo do të ishte krejtësisht e pamundur. Prandaj, detyra kryesore e institucionit, që unë kam nderin të drejtoj, është që të vendosë aleanca të vërteta (për këtë ne ia kemi dalë në sektorin e investimeve në fushën e infrastrukturave hoteliere), me investitorët që duam në investojnë në fushën e agroturizmit, për shtimin e kapaciteteve të guidave, për shtimin e kapaciteteve të udhërrëfyesve turistikë, për shtimin e kapaciteteve të çdo bashkie të vendit tonë. Një nga detyrat tona kryesore për implementimin e buxhetit të ardhshëm është krijimi i 61 zyrave lokale në 61 bashki dhe arsytet pse turistët duhet të vizitojnë të 61 bashkitë e vendit.

Çdo bashki e vendit dhe çdo ish-komunë apo fshat, në kuadrin e 100 fshatrave, mund të shndërrohet në destinacion turistik nëse ka më shumë buxhet, më shumë vëmendje dhe duke kuptuar që ky buxhet do të sjellë shumë më tepër para, mirëqenie dhe punësim për atë sektor.

Këto ishin ato që doja të thosha për fushën e turizmit. Thelbi do të jetë në rritjen e numrit të turistëve për vitin tjetër nëpërmjet politikave dhe masave që do të ndërmarrim, por edhe në mbështetjen e investimeve të vërteta në kuadër të hoteleve me 4 dhe 5 yje.

Sot, të nderuar kolegë deputetë, mund t’ju them se më pak se një vit nga lançimi i paketës së re (të mos harrojmë se paketa për fashën e plotë të legjislacionit në nxitje të investimeve u miratua në pranverën e këtij viti) ne kemi 10 -15 kompani, të cilat janë gati të fillojnë investimet në hotele me pesë yje në bregdet dhe në zonat me përparësi zhvillimi turizmin, siç kemi edhe investime të vërteta në qendrat e qyteteve tona.

Pra, ndihem shumë mirë që kjo politikë ka dhënë frytet e veta. Pas pak ditësh do të kemi lajme shumë të mira për disa emra të rinj që futen në botën e zhvillimit të hotelerisë në vendin tonë.

Për sa i përket mjedisit, që është po ashtu sektor shumë i rëndësishëm i mbështetur me investimeve në vendin tonë, siç jua thashë, në kuadër të politikave të *clean and green*, ne kemi përcaktuar disa nga fushat, për të cilat ka pasur një debat shumë të madh në vendin tonë, për sa i përket politikave që kemi ndjekur për një filozofi të re për guroret, pikat e grumbullimit të skrapit, problematikave të menaxhimit të gjithë makinave, të cilat hyjnë në vendin tonë, menaxhimit të gjithë faktorëve që kanë të bëjnë me reduktimin e qeseve plastike.

Kjo është një politikë e re që po ndjek ministria jo vetëm për reduktimin e qeseve plastike, por edhe për reduktimin e të gjitha plastikave njëpërdorimshme që futen në Shqipëri. Kjo në kuadër të politikave të Bashkimit European për të reduktuar më shumë përdorimin e plastikave.

Për sa u përket politikave që ne po ndërmarrim në fushën e vend-depozitimeve të mbetjeve urbane, që do ta diskutojmë pas pak së bashku, ne kemi kërkuar që për sezonin e ardhshëm turistik të kemi jo vetëm operacione pastrimi, por operacione të vërteta ndërhyrjeje në vend-depozitimet e mbetjeve urbane dhe në politikat që ne ndjekim me pushtetin lokal për të menaxhuar fondet në këtë sektor.

Për të kaluar te vend-depozitimet e mbetjeve urbane, një vit më parë, kur e lançuan së bashku në këtë komision dhe kemi bërë këtë debat, ne kemi premtuar disa masa konkrete për të shkuar në një hartë të re të vend-depozitimeve të mbetjeve urbane në vendin tonë. Besoj që ia kemi dalë të realizojmë gjithçka kemi thënë një vit më parë në këtë komision. Pra, ia kemi dalë të bëjmë një politikë krejt tjetër në menaxhimin e pushtetit lokal. Kemi miratuar në qeveri vendimin për kosto-tarifën e menaxhimit të mbetjeve urbane. Kemi arritur të miratojmë në qeveri dhe në parlament projektligjin e ri për ndryshimet në ligjin ekzistues për sa i përket strukturës që duhet të ketë çdo bashki për menaxhimin e mbetjeve urbane, pra për landfillet. Kemi arritur të bëjmë një hartë të të gjitha vend-depozitimeve të mbetjeve urbane legale dhe ilegale në vendin tonë.

Ajo që na duhet nga ky komision i nderuar, është mbështetja me më shumë buxhet për eliminimin e të gjitha vend-depozitimeve të mbetjeve urbane ilegale dhe më pas për të punuar me bashkitë, me fondet që ato kanë në dispozicion, por edhe me fondet shtesë nga buxheti i shtetit aty, ku bashkitë e kanë të pamundur që të vendosin përfundimisht një politikë krejt tjetër.

Pra, nëse ne nuk kemi një aleancë duke filluar nga ky komision, me grupet parlamentare (pozitë-opozitë) dhe me 61 kryetarët e bashkive, me prefektët dhe me kryepleqtë, si dhe me institucionet që menaxhojnë të gjithë sistemin e mbetjeve urbane në vendin tonë, Shqipëria do të vazhdojë të jetë e papastër.

Shqipëria do të vazhdojë të jetë e papastër nëse ne nuk arrijmë të mbyllim 198 pikat, të cilat ne i kemi evidentuar së bashku me prefektët dhe me projektin e qeverisë zvicerane, ku ka vend-depozitime ilegale, të cilat janë në përgjithësi në shtretërit e lumenjve dhe në zonat pranë bregut të detit. Nëse nuk do të arrijmë t'i eliminojmë ato, sa herë që do të bjerë shi, do të kemi probleme me mbetjet. Me pak investime, por me shumë punë dhe në aleancë më të fortë me 61 kryetarët e bashkive, ne mund t'ia dalim që brenda këtij viti, duke shkuar

në projektin tonë “*Clean and green 2020*”, pra për të pasur një Shqipëri më të pastër deri në vitin 2020, që të eliminojmë vend-depozitimet ilegale, të vendosin së bashku me bashkitë vend-depozitimet legale të mbetjeve urbane dhe të bëjmë zgjidhjet e mëdha me landfille dhe me inceneratorë, që t’i zgjidhim përfundimisht këto probleme. Të kalojmë nga zgjidhja e problemeve të vogla për të shkuar te zgjidhjet e mëdha. Mendoj se ky do të jetë një kapitull shumë i rëndësishëm edhe në buxhetin e vitit 2018 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe një kapitull shumë i rëndësishëm i punës sonë gjatë vitit të ardhshëm.

Çështja e fundit, por jo nga rëndësia, të nderuar kolegë deputetë, duke njohur edhe dimensionin tuaj të dashurisë për natyrën dhe të detyrë kryesore që ka ky komision, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, një kapitull shumë i rëndësishëm për vitin e ardhshëm, i cili nuk ka aq sa duhet pasqyrim në buxhet, që do të donim të kishte më shumë para, do të jetë vazhdimi i aksionit tonë për mbjelljen e 20,2 milionë pemëve deri në vitin 2020.

Për ta sqaruar, nuk kërkojmë të mbillen pemë vetëm në pyje. Ne kemi nisur që vjet një punë të madhe. E kemi realizuar në mënyrë të konsiderueshme këtë proces. Nga përlllogaritja e ministrisë, janë mbjellë mbi 4-5 milionë pemë në të gjithë vendin në zonat pyjore, pemë dekorative në 61 bashkitë e vendit, të cilat janë angazhuar në mbjelljen e disa qindra mijëra pemëve. Pemët e mbjella me mbështetjen e buxhetit të shtetit nëpërmjet bujqësisë dhe pemët agropërpunuese, si dhe pemët e mbjella nga vetë fermerët në shkallë vendi.

Në qoftë se ne do të vazhdojmë të kemi mbështetje nga kolegët (më shumë se sa mbështetja me fonde do të kërkojmë mbështetje politike dhe mbështetje me prezencën e tyre), do t’ia dalim.

Po ashtu, kërkojmë mbështetje në përhapjen e mesazhit për projektin e ministrisë “*Clean and green 2020*” (Krijo oksigjenin tënd). Brenda muajit do të lançojmë fushatën e muajit të mbjelljeve dhe kjo fushatë do të vazhdojë deri në prill. Ne do të kërkojmë angazhimin e të gjithëve, duke filluar nga deputetët deri tek çdo qytetar, për t’i kërkuar çdo shqiptari që të angazhohet në këtë fushatë që të kemi një situatë krejt tjetër për mbrojtjen e mjedisit, mbjelljen e pemëve dhe promovimin e Shqipërisë turistike.

Për sa u përket shifrave të buxhetit, ju ato i keni dhe unë besoj se relatori Bare do të shprehet për rritjen e konsiderueshme që ka buxheti i këtij viti, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në total, pasi siç thashë, nëse do të kërkonim për gjithë sa thashë, kjo është një shifër e mangët, pasi i gjithë buxheti i shtetit, duke filluar nga ministria lider për investimet në fushën e infrastrukturës; Ministria e Shëndetësisë për sa i përket rritjes dhe plotësimit për herë të parë në këtë vit të 300 qendrave të shërbimit shëndetësor, sidomos në zonat

turistike; për Ministrinë Bujqësisë, për rritjen e projektit të përbashkët për agroturizmin “100 fshatrat”; për sa u përket investimeve që vijnë nga institucionet e tjera, sidomos nga Ministria e Financave për arsimin profesional e Ministria e Brendshme dhe ajo e Mbrojtjes në kuadër të mbështetjes së gjithë këtyre politikave, mendoj që buxheti i vitit 2019 shënon përsëri një rekord në rritjen e investimeve në këtë sektor.

Po ashtu, mendoj se sektorët së bashku shënojnë rekord në industrinë që prodhon më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit.

Prandaj, duke ju falënderuar kolegë deputetë për mbështetjen që keni dhënë gjatë gjithë këtij viti, do t’ju ftoja të ishim përsëri bashkë në një përpjekje të përbashkët për të shtuar mirëqenien, punësimin dhe paratë në familjet shqiptare nëpërmjet një turizmi më të qëndrueshëm!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj - Faleminderit!

Komplimente për punën që keni bërë në këtë vit turistik! Kam parasysh sezonin e verës, krahasuar me vitin e mëparshëm, që sigurisht, ka pasur progres dhe një përmirësim të ndjeshëm të menaxhimit të mbetjeve. Ky lloj vëzhgimi nuk është politik apo personal, por vjen nga vetë qytetarët dhe nga turistët e ndryshëm që kanë ardhur dhe që bëjnë dallim të madh në krahasim me një vit më parë. Ndonëse e dimë që ju keni një buxhet shumë modest në këtë drejtim dhe mendoj që ende, pavarësisht prioriteteve që kemi në këtë fushë, nuk kemi përcaktuar saktësisht mekanizmat ekonomikë për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Unë kam 2-3 pyetje.

E para, është e lidhur me një nga problemet e rëndësishme që edhe opinionin publik dhe jo vetëm, se edhe përtej vendit tonë ka interes: monitorimi i saktë, i besueshëm i ekosistemeve të ndryshme. Këtu kam parasysh kryesisht zonën bregdetare. Sipas asaj që kam parë këtu, vlera e vënë në buxhet është jashtëzakonisht modeste, aq sa unë dyshoj, nëse institucionet përkatëse do të arrijnë me ato para të kryejnë një monitorim realisht të besueshëm dhe përfaqësues, që do të na shërbejë për të gjithë zonën bregdetare. Në këtë kontekst, unë do t’i propozoja komisionit që në bashkëpunim me ministrinë, të dalë me një propozim për ta rritur këtë vlerë, në mënyrë që të ketë minimalisht rezultatet, të cilat janë të mundura të realizohen nga pikëpamja shkencore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, vetëm për monitorimin. Për laboratorin është histori tjetër. Kushtet e AKM-së janë jashtëzakonisht kritike. Ne sapo kemi bërë një vizitë me kryetarin e komisionit në atë agjenci, konditat e së cilës nuk janë normale edhe nga pikëpamja e ruajtjes së shëndetit të njerëzve aty, por mbi të gjitha, të standardeve për të kryer një analizë të besueshme.

Pyetja tjetër ka të bëjë me propozimin që kemi bërë në komision në lidhje me një taksë të ambalazhit, që është vendosur 35 lekë për çdo kilogram plastikë.

Ne bëjmë një propozim që mendoj se mund të shërbejë si një mekanizëm ekonomik për të nxitur grupe dhe komunitete të ndryshme për maksimalizimin e grumbullimit të mbetjeve plastike.

Propozimi është: për çdo ton të mbledhur, të jepen 10 mijë lekë të reja dhe kjo të hiqet nga sasia që futet në buxhetin e shtetit, që i bie rreth 35 mijë lekë të reja për ton. Ishte 35 lekë për kilogram dhe i bie rreth 35 mijë lekë të reja për ton. Në këtë mënyrë ne mund ta adresojmë këtë edhe për grumbulluesit, por njëkohësisht unë mendoj se edhe iniciativat që janë marrë herë pas here nga ushtria për pastrimin e këtyre mbetjeve, sigurisht kanë vlerën e tyre. Ne këtu mund të përfshijmë veçanërisht shkollat. Edhe pse interesi është i vogël, modest, shkollat, duke pasur një mekanizëm të tillë ekonomik, krahas dëshirës që kanë të rinjtë për të pasur një vend sa më të pastër, mund t'i nxisë ata për t'u përfshirë në mënyrë sistematike në pastrimin e zonave të ndryshme dhe territoreve të ndryshme. Kjo mund të bëhet në nivel kombëtar, për të gjithë vendin.

Një moment tjetër që unë mendoj se është i rëndësishëm dhe duhej të ishte parashikuar në projektbuxhetin e shtetit, është i lidhur me dixhitalizimin e të dhënave që kanë të bëjnë me monitorimin. Po që se do të bisedosh me njerëzit që kanë punuar në vite, thonë se janë monitoruar tregues të ndryshëm dhe këto ekzistojnë. Por ato ndoshta ekzistojnë në raporte, që flenë në sirtar. Njerëzit apo institucionet shkencore brenda vendit, por edhe jashtë tij, janë të interesuar shpesh të shikojnë ecurinë e këtyre të dhënave në lidhje me indikatorët e ndryshëm. Po i referohem përsëri zonës bregdetare.

Pse nuk keni parashikuar ju në buxhet, apo hajdeni të bëjmë diçka bashkërisht për ngritjen e këtyre *database*-ve, që janë jashtëzakonisht të rëndësishme në shumë aspekte?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ta bëjmë pyetje-përgjigje, që ta kemi më kollaj.

Urdhëroni!

Blendi Klosi - Faleminderit!

Në fakt, qenia ministër më kujton se sa shumë arsye ne kemi për të bashkëpunuar së bashku me ju dhe për të ndarë opinionet, mendimet dhe vlerësimet.

Të gjitha ato që tha deputeti Baraj qëndrojnë dhe janë çështje që ne duhet t'i diskutojmë së bashku. Unë jam i gatshëm të vij dhe të diskutoj në këtë komision sa herë që të ketë ide të reja, si kjo e mbështetjes nëpërmjet një politike fiskale apo ideja për të vendosur më shumë standarde në monitorimin, realizimin dhe rritjen e kapaciteteve, që duhet të kemi në të gjithë sektorët për të pasur më shumë informacion.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e kuptoj që historia 27-vjeçare e ka bërë sistemin e mjedisit një sistem për të cilin janë kujtuar shumë pak.

Unë ju falënderoj shumë që gjatë këtij viti që unë kam qenë në drejtim të institucionit, ne kemi folur pothuajse çdo ditë. Nuk diskutohet që kemi folur 3 herë në javë për çështje që kanë të bëjë me mjedisin. Realisht, shqetësimet e zotit Baraj janë edhe shqetësimet e mia të drejtpërdrejta. Si do të realizojmë një sistem të qëndrueshëm monitorimi të treguesve të ndotjes mjedisore? Si do të arrijmë ne që së bashku me ju dhe me komunitetin të kuptojmë se sa të rëndësishme e kemi vendosjen e një sistemi të ri? Ne kemi punuar gjatë këtij viti dhe unë mendoj se një nga pikësynimet tona më të mëdha është vendosja një nga sistemet *online* të lejeve mjedisore dhe të monitorimit të tyre. Sot është e vërtetë që ka një sistem *online* të lejeve mjedisore, por një sistem të lejeve si leje dhe jo të karakteristikave, që ka brenda një leje.

Ne po punojmë që për të paktën 18 industri të grupuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (ndoshta edhe më shumë se kaq), do të përcaktojmë kritere të veçanta për secilin leje. Pra, siç e kemi bërë për guroret, për skrapin, për plastikën, për vend-depozitimin e mbetjeve dhe për shumë sektorë të tjerë si ai i lëkurëve apo i mbetjeve të tjera, do të arrijmë të bëjmë 18 grupime lejesh mjedisore. Për këto 18 grupime do të ketë karakteristika të veçanta të monitorueshme. Po ashtu, brenda këtij sistemi monitorimi *online* do të donim të kishim edhe sistemin e realizimit të këtyre lejeve mjedisore apo të mbrojtjes së karakteristikave për secilin tregues. Kjo është një punë që po kryhet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, së bashku me Agjencinë Kombëtare të Informacionit (AKSH) dhe besoj se brenda pranverës së këtij viti ky sistem do të jetë i implementuar dhe do të kemi një sistem shumë më të mirë monitorimi.

Unë e di që kemi probleme me pajisjet, me atë që thatë ju me buxhetin, por viti 2018 shënoi për herë të parë një investim të shumëfishtë për vendosjen e sistemit të monitorimit të ajrit në qytetet tona kryesore. Ky investim do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2019 për të vendosur një sistemi monitorimi *online*.

Ne s'mund të mbetemi te deklaratimet e kompanive nëpërmjet agjentëve të ndryshëm mjedisorë për shkarkimin në ajër, në ujë, për ndotjen që vjen nga industrinë, por mendoj se ne duhet të vendosim një sistem të pavarur monitorimi *online*, i cili do të jetë edhe një tregues i punës sonë të përbashkët.

Në qoftë se gjykojmë nga çfarë deklarojnë kompanitë nëpërmjet vetëdeklarimeve dhe nëpërmjet agjentëve privatë, Shqipëria duhet të ishte vendi më i pastër në botë.

Në qoftë se gjykojmë nga ajo që ndodh në realitet, padyshim, kemi probleme. Për të ndryshuar këtë dimension, të cilin logjika e këtyre 25 vjetëve e ka lënë në rënie të lirë, ne do të vendosim sistemi monitorimi të lejeve *online*, duke u futur edhe në sistemet e implementimi të lejes mjedisore *online*, që besoj se do të sjellë një hap shumë të madh përpara në përmirësimin e së vërtetës. Ne na duhet e vërteta, që të mos mbetemi pjesë e hamendësimeve për sa i përket asaj që kemi bërë me mjedisin.

Po të gjykojmë se si mund të ndryshojmë dhe se sa kemi ndryshuar me punë të përditshme edhe pa shumë buxhet, por me shumë energji dhe me shumë dashuri për këtë punë, mendoj se mund t'ia dalim që në vitin 2020 të kemi një Shqipëri shumë më të pastër, sepse mendojmë se eliminimi i shkaktarëve që ndotin, është shumë më i rëndësishëm se sa aksionet, që po ashtu janë shumë të rëndësishme, sepse fusin shumë më tepër vullnetarë. Mendoj se ky vit do të ketë përsëri nevojë për kontribut vullnetar. Ne po bëjmë plane me shoqërinë civile, me struktura të shtuara për të bërë përsëri operacione të mirëmbajtjes së realitetit në të cilin jemi, por kjo nuk mjafton. Ne na duhen operacione të mirëfillta monitorimi dhe operacione të realizuara dhe të mirëpërpunuara të reduktimit nëpërmjet mekanizmave ligjore, administrative, por edhe teknologjike, që janë sot shumë të përparuara në botë.

Ju e keni buxhetin e vitit 2019 dhe gjykoni vetë nga ky buxhet se sa shumë investime ka në këtë buxhet për infrastrukturën e menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve. Zgjidhjet e mëdha që po ndodhin në Shqipëri, që duhen shoqëruar edhe me problematikat e historisë së rreth 3 dekadave, si vend i depozitimeve të mbetjeve natyrore, të trajtimit të ujit si pastrues i vetëm i ish-komunave (tashmë bashkive) në rrethinat e bashkive, rritja e përgjegjësisë publike, por edhe administrative dhe vendosja e një sistemi më të fortë gjobash dhe detyrimesh ligjore, sidomos kryetarëve të bashkive që nuk duhet të mendojnë vetëm për qendrat e qyteteve apo të ish-bashkive të vjetra, por duhet të kuptojnë se reforma territoriale është bërë për të pasur një bashki të pastër cep më cep apo për të pasur edhe te zona më e largët një shërbim që e merr qyteti apo ish-bashkia e vjetër, , ne nuk ia dalim dot sado buxhet të kemi.

Prandaj, shumë faleminderit, zoti Baraj! Ju gjithmonë jeni profesori ynë në fushën e mjedisit dhe keni gjithmonë me pak cedime, njeriu ideal në mbrojtje të mjedisit.

Jemi të hapur ta dëgjojmë këtë debat nga ju.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Suli!

Rakip Suli – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, zoti Ministër!

Gjatë diskutimit tuaj i dhatë shumë rëndësi pastërtisë dhe ajo që thatë është shumë e vërtetë. Nëse para disa kohësh ishte një Shqipëri e ndotur, sot nuk mund të themi se është e pastër, por është bërë një punë titanike në këtë drejtim.

Realisht, nëse flasim për turizmin, pa pasur një Shqipëri të pastër, nuk mund të kemi turizëm.

Gjithashtu, edhe infrastruktura ka ndikim të drejtpërdrejtë te turizmi. Siç dihet, edhe projekti “1 miliard euro” vazhdon të japë një impakt pozitiv në këtë fushë.

Unë do të thosha se keni kapur një pikë shumë të rëndësishme. Në rast se nuk do të kemi në radhë të parë, 61 bashkitë të ndërgjegjësuara dhe të përkushtuara për sa i përket pastërtisë në të gjithë territorin, është krejt e pamundur të kemi një Shqipëri të pastër nesër. Mendoj se edhe ju, si ministri duhet të jeni pak më korrektë për t’i penalizuar ato bashki, të cilat nuk punojnë me ndërgjegje dhe me përkushtim për pjesën e pastërtisë.

Unë do të thosha se për të pasur një Shqipëri të pastër duhet të ketë më shumë përkushtim sesa një faturë ekonomike më të madhe. Faktori ekonomik ndikon më pak sesa ndërgjegjësimi për ta mbajtur vendin të pastër.

Meqenëse është folur për 100 fshatra, për agroturizmin, doja të dija çfarë është bërë dhe çfarë mendohet të bëhet për to?

Prekët çështjen e shkollave profesionale. Normalisht, është një pikë shumë e rëndësishme, që këto 4 vjet i është dhënë prioritet shumë i madh, sepse është bërë orientimi i personave, që nesër të gjejnë punën konkrete dhe për të pasur një specializim në atë fushë.

A mendoni se ndryshimi që u bë (e kam fjalën për menaxhimin e këtyre shkollave) ishte pak i gabuar, sepse kaloi nga ministria e...?

Bledi Klosi – Ka ikur.

Rakip Suli – Jo, ka shkuar te ekonomia, apo jo?

Blendi Klosi – Ka ikur ai si ministër.

Rakip Suli – Nuk ka lidhje kjo.

A mendoni se duhet të jetë te ministria juaj?

Desha një përgjigje konkrete.

Blendi Klosi – Shumë faleminderit, zoti Rakip!

Për sa u përket 100 fshatrave, e kemi bërë këtë diskutim. 100 fshatrat janë 100 modelet e para, që po marrin një vëmendje shumë të veçantë nga të katra ministratë e involvuara në këtë proces: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Turizmit dhe Ministria e Kulturës, për t'i shndërruar këto fshatra në 100 modelet e para të zhvillimit real të zonës rurale. Mbas “Rilindjes urabane”, “Rilindja rurale” do të marrë vëmendjen e posaçme nëpërmjet këtyre 100 fshatrave, për të cilat akademia e 100 fshatrave ka përgatitur projekte konkrete, mundësi reale të transformimit të tyre në potenciale ekonomik, por në këtë kuadër edhe 4 institucionet tona kanë vendosur politika të reja.

Për sa i përket ministrisë që drejtoj, për infrastrukturën turistike të këtyre fshatrave ajo do të bëjë shumë më tepër investime se këtë vit, do të përcaktojë arsyet përse këto fshatra duhen vizituar nga turistët e huaj dhe posaçërisht nga ata vendas, si dhe politika promovuese për ndërtimin e infrastrukturës agroturistike. Pra, janë ndërtuar 100 fshatra brenda një logjike të caktuar, për të krijuar itinerare të vizitave turistike, si dhe për shndërrimin e tyre në destinacione për t'u vizituar.

Promovimi dhe çuarja nëpërmjet politikave që ndjekim me ture operatore, që të shkojnë më shumë turistë në to, do të rrisë, në fund të fundit, atë që bën turizmi kudo dhe në çdo segment, të ardhurat për punësim, mirëmbajtje, investime të reja dhe arsyet e vërteta pse këto fshatra duhet të preken apo të trumbetohen si modele zhvillimi të zonave rurale. 100 fshatrat, në pesën më të madhe, janë zgjedhur sepse kanë potencial për t'u shndërruar në qendra të vizitueshme. Pa dyshim, ka edhe shumë të tjera, prandaj është politika e 100 fshatrave dhe 100 fshatrat plus. Pra, çdo fshat mund të shndërrohet në një nga 100 fshatrat, por për këto 100 të parat, këtë vit do të japim më shumë buxhet, për të bërë strukturën infraturistike, pra informacione turistike dhe arsyet pse këto fshatra janë përzgjedhur.

Për sa u përket shkollave profesionale, mendoj se është bërë një politikë shumë e drejtë që janë shkëputur nga sistemi i arsimit, sepse qenia brenda sistemit të arsimit e godiste gjithmonë arsimin profesional, duke e shndërruar atë në sektorin e fundit të edukimit të të rinjve.

Mbështes dhe jam besimplotë se shkëputja nga sistemi i arsimit, duke e lidhur me punën, me ekonominë, me prodhimin e drejtpërdrejtë të arsimit profesional dhe atë çfarë kemi bërë, pra me vendosjen e sistemit dual, ku në fund nxënësit marrin një pjesë të konsiderueshme të edukimit, duke marrë edhe edukimin bazë dhe duke u dhënë nxënësve të arsimit profesional, jo mundësinë e fundit që u jepnim kur ishin brenda arsimit, por një nga mundësitë për t'i zhvilluar ata, për të gjetur profesionin, tregun e punës, për të pasur

mundësinë për të vazhduar në universitete dhe në arsimin e lartë, është një logjikë shumë drejtë dhe ka vend që arsimit profesional të krijojë shumë politika.

Për sa i përket sektorit që unë mbroj, turizmit, pa dyshim, duhet dhjetëfishuar numri i nxënësve të arsimit profesional.

Problemi kryesor i turizmit shqiptar sot është shërbimi, i cili nuk bëhet dot vetëm me nxënësit e arsimit profesional, por gjithë shoqëria duhet të fillojë të mendojë si do t'i shërbejë turizmit, si të kemi më shumë njerëz që jetojnë me turizmin, si të kemi më shumë biznese që jetojnë me turizmin dhe, në fund të fundit, të mos frikësohemi se sezoni që vjen nuk do të krijojë mundësinë për të pasur ekonomi.

Tani që kemi mbyllur sezonin e vitit 2018, jemi besimplotë që i gjithë sistemi e kupton se vitin tjetër do të ketë përsëri biznes, pra nuk e kemi frikën e sezonit të ardhshëm. Frika jonë është cilësia dhe për të realizuar një cilësi më të mirë na duhet më shumë edukim profesional në të gjitha nivelet, në nivelin më të lartë menaxherial të hoteleve me 5 yje, që po hapen në vendin tonë apo në investimet e vërteta deri në hotele me 4 yje, që janë bërë masive. Këto hotele kanë problem të madh menaxherial, nuk duan nxënës të arsimit profesional, por duan profesorë të menaxhimit, duan njerëz të shkolluar jashtë, njerëz të edukuar në sistemin tonë arsimor, me mastera dhe nivele të larta edukimi, për të menaxhuar bizneset, që në disa prej hoteleve që ka Shqipëria sot, arrijnë në nivele shumë të larta, pra kanë 400, 500, 600 dhoma për të menaxhuar, mijëra shtretër, me dhjetëra mijëra turistë në vit dhe duan nivel kualifikimi në të gjitha shtresat. Nuk duan vetëm kamerierë e banakierë, por duan menaxherë, mekanikë, furnitorë, shoferë, kuzhinierë, njerëz që lyejnë, që pastrojnë...

Kemi problemë me shërbimin, të nderuar kolegë deputetë, prandaj politika e risimit profesional, për mua, është një nga kapitujt më të rëndësishëm të suksesit të kësaj qeverisjeje dhe politike.

Eduard Shalsi – Zonja Gjermani e ka fjalën, më pas zoti Bitri.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin dhe punën e bërë në dy sektorë me shumë sfida!

Te pjesa e turizmit, pa dyshim, do të vlerësoja shumë punën e bërë për promovimin e Shqipërisë kudo në botë. Them se një nga rezultatet e këtij promovimi ka qenë, pa dyshim, rritja e numrit të turistëve. Fakti që vazhdojmë të kemi turistë edhe tani dhe jo vetëm në sezonin veror, mendoj se është bërë një punë e mirë nga të gjithë aktorët, nga ministria, agjencia e turizmit, por edhe nga sektori privat. Rritja e numrit të turistëve është një gjë shumë pozitive.

Ndërkohë, ju keni edhe sektorin tjetër dhe duhet të ruani dhe mjedisin. Megjithatë rritet numri i turistëve, duhet pasur parasysh që të jetë turizëm i qëndrueshëm, që të mos dëmtohet mjedisi. Prandaj them se sfida është shumë e hapur.

Për sa i përket buxhetit, përmendët që ka rritje. Mendoj se të gjithë faktorët apo komponentët e tjerë që mbështeten nga ministritë e tjera, e plotësojnë sektorin e turizmit, duke ju dhënë më shumë mundësi për ta zhvilluar më tej dhe për të arritur objektivat tuaja vitin që vjen.

I kemi ndjekur me shumë kujdes ministrat e tjerë, edhe ministrin Gjignuri, i cili foli për investimet në infrastrukturë, që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e turizmit, si dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që përmendi projektin e Alpeve dhe projektin e Bankës Botërore në Jug të Shqipërisë. Besoj se kjo i jep një hov cilësor turizmit.

Doja t'ju pyesja për mbështetjen që kemi dhënë ne si qeveri dhe si parlament, duke ulur TVSH-në e turizmit për hotelieritë. Kjo mbështetje, a ka pasur impakt në formalizmin e këtij sektori, pra në rritjen e të ardhurave që ky sektor sjell në ekonominë shqiptare? Po kështu edhe për agroturizmin, duke qenë se kemi ndërmarrë hapa pozitivë për ta mbështetur. Mendoj se është një nga sektorët që do të rrisë shumë zhvillimin e turizmit në Shqipëri dhe ka hapa pozitivë. Kemi vënë re që ka rritje, pasi kemi marrë masat pozitive mbështetëse për agroturizimin.

Ndërkohë, për mjedisin kam një pyetje dhe një kërkesë për ju, zoti Ministër.

Duke qenë se jam deputete e bashkisë së Krujës, kërkoj ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj për ndërhyrje konkrete, jo vetëm për masakrën mjedisore që është bërë në Krastë të Krujës, por edhe për ndotjen e ajrit, që një sërë fabrikash, uzinash apo kompanish private, bëjnë në këtë zonë. Qytetarët e Krujës janë shumë të shqetësuar, sepse jetojnë çdo ditë aty, pa dyshim, edhe turistët, por, në radhë të parë, flas për qytetarët.

Kërkoj nga ju një monitorim më të fortë, më të rreptë, ndaj të gjitha kompanive, që t'i respektojnë rregullat e pastrimit të ajrit, filtrimit dhe të mosndotjes së ajrit përmes tymrave apo gazrave që prodhojnë. Në mënyrë të veçantë, për këtë zonë kam vërtet shumë shqetësim.

Faleminderit!

Blendi Klosi – Shumë faleminderit, e nderuar kolege!

Jo për të shkëmbyer komplimente, por, realisht, numri i turistëve nuk mund të ishte (dhe nuk e mendoj se është) një përpjekje e bërë nga institucioni që drejtoj sot, as këtë vit, por është një përpjekje që ka nisur prej shumë kohësh dhe janë politikat që kemi ndjekur që në 2013-n, kur morëm drejtimin e vendit dhe kuptuam se turizmi do të ishte një sektor shumë i

veçantë i zhvillimit dhe promovimit të vendit, si dhe një sektor shumë i rëndësishëm ekonomik.

Prandaj, ju komplimentoj për punën e bërë, për promovimin dhe ngritjen e agjencisë në nivelin ku duhet, si dhe për futjen e Shqipërisë si destinacione turistik prej disa vitesh!

Ju e keni drejtuar atë sektor dhe besoj se e dini sa e rëndësishme është që sektori të mbështetet nga një aleancë sa më e gjerë. Prandaj, mendoj se sot kemi një moment shumë pozitiv për sa i përket aleancës me faktorët që bëjnë turizmin.

Ajo që thatë, me shumë të drejtë, është shqetësim për ne. Rritja e numrit të turistëve, për çdo ministër do të ishte një moment krenarie. Për mua, është moment rritjeje përgjegjësish, sepse nga vjet, kur kishim 5 milionë turistë të huaj të hyrë në Shqipëri, pa llogaritur turizmin e shqiptarëve, që kthehen për të kaluar pushimet në vendin tonë, që, pa dyshim, e shton në mënyrë të konsiderueshme këtë numër, sivjet kemi 6 milionë. Vitin tjetër presim të shkojmë në 7 milionë turistë të huaj, që vizitojnë Shqipërinë. Pra, kemi përgjegjësi shumë të madhe të strukturave shtetërore dhe nuk mund të presim që, me mekanizma të një kohe kur turizmi nuk konsiderohet, të menaxhojmë, pasi rritja e numrit me progresion kaq të madh mund të shkaktojë trauma për të gjithë sistemin.

Prandaj, ju keni shumë të drejtë, ne duhet të kuptojmë më qartë se cilat janë rregullat e lojës në botën e turizmit, se cilat janë rregullat e lojës ndërmjet aktorëve dhe faktorëve që menaxhojnë turizmin, pra turet operatore, kompanitë, *incoming*, *outgoing* dhe kompanitë, të cilat investojnë dhe duhet të kuptojnë që, kur bëjnë kontrata me partnerë seriozë europiane, që funksionojnë në të gjithë botën, nuk mund të menaxhojnë duke thënë: “Hë, se Shqipëri është”.

Tani po futemi në turizmin global dhe turisti gjerman, anglez, polak, çek, nga çdo vend i botës, kur zgjedh destinacionin, nuk mendon se po shkon në destinacione ku u pranohen cedimet.

Vendosja e sistemeve të kontrollit të standardeve të cilësisë dhe vendosja e një raporti të drejtë ndërmjet ekonomisë që fitojmë, por edhe parave që duhet të shpenzojmë, janë shqetësim shumë i madh për ne .

Në këtë kuadër, në lidhje me promovimin, në buxhetin e ardhshëm do të shtojmë buxhetet për promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik, por edhe me target të caktuar për destinacione apo tregje, të cilat do t'i marketojmë si të mundshme për të afruar turizmin në Shqipëri.

Po vij nga një vizitë në Poloni, ku takova ministrin polak. E falënderova për një turizëm shumë interesant të shtetasve polakë në Shqipëri dhe të gjithë zonës së Europës së re,

që e shohin Shqipërinë si një destinacion shumë të përshtatshëm për ta. Në qoftë se numri i polakëve në Shqipëri është shtuar dhe nga 2016-a ka qenë 60 mijë, në 2017-n ka shkuar 120 mijë. Sivjet presim të shkojë 180 mijë-200 mijë. Pa dyshim, atij destinacione do t'i japim më shumë *spacio*.

Në qoftë se destinacioni i vendeve nordike është shtuar me ritme shumë të shpejta këta 2 vjet, do të ketë *spacio* në promovimin tonë, destinacione, të cilat i afrohen tregut shqiptar, me kushtet, standardet dhe cilësinë që kemi. Pa dyshim, do të kërkojmë të bëjmë politika të orientuara për tregje, pasi kështu bën gjithë bota, nuk po bëjmë ndonjë shkencë të veçantë, por po bëjmë atë që të tjerët kanë bërë kur dua që të rrisim numrin e turistëve, por kjo duhet arritur me vendosjen e rregullave më të forta.

Siç e thashë në hyrje të kësaj fjale, shtimi i numrit na shton përgjegjësitë dhe na bën të kuptojmë që jemi në një konkurrencë shumë të madhe. Ne jemi midis destinacioneve shumë të forta turistike, që shumë thjesht mund të na marrin biznesin tonë, si Kroacia, Greqia, Mali i Zi, Turqia, Italia, me të cilat ne duam të jemi konkurrentë. Kështu që, pa rregulla kjo punë nuk mund të realizohet.

Për sa i përket shqetësimit tuaj si deputete e Krujës, në kuadër të politikave që kemi ndjekur për forcimin e zonave me përparësi zhvillimi turizmin dhe zonave të mbrojtura natyrore, në të gjithë zonën ballore të malit të Krujës, ku sot po zhvillohet një pjesë e konsiderueshme e turizmit shqiptar, por edhe për një premtim të fortë elektoral të vitit 2013 për të mbyllur aktivitetin e dëmtimit të kësaj zone nëpërmjet guroreve, kemi ndërmarrë tre aksione shumë të rëndësishme.

Së pari, sot në zonën e Krujës dhe Fushë-Krujës nuk ka aktivitet të furrave të gëlqeres. Para pesë apo gjashtë muajve bllokuam dhe prishëm 33 furra dhe më pas edhe nëntë të tjera. Policia e Shtetit ka arrestuar një numër të konsiderueshëm të poseduesve të këtyre gropave të gëlqeres. Shpresojmë që sot të mos kemi asnjë gropë gëlqereje që ndot malin e Krujës.

Megjithatë, në qoftë se komuniteti i Krujës dhe i Fushë Krujës do të jenë aleatët tanë dhe do të njoftojnë për çdo rast, veprimi i shtetit nëpërmjet Inspektoratit të Mjedisit, por edhe Policisë së Shtetit do të jetë i menjëhershëm për të mos i lejuar. Në fakt ato janë shembulli më çnjerëzor i përdorimit kriminal të mjedisit.

Për sa u përket problematikave të guroreve në malin e Krujës, besoj se jeni njohur me vendimin e qeverisë të datës 26 korrik të vitit 2018 që zona e malit të Krujës u shpall peizazh i mbrojtur turistik. Që nga ai moment veprimtaria e të gjitha guroreve u vu në monitorim nga të dyja institucionet tona, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Energjetikës. Nga 16 operatorë

që ushtrojnë aktivitetin, 5 prej tyre u janë hequr lejet mjedisore dhe minerare. Po mbyllen një numër i konsiderueshëm guroresh dhe brenda pranverës së vitit të ardhshëm të gjitha guroret që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën që ju përmendët do të largohen nga ajo zonë. Më pas do të fillojë procesi i rehabilitimit duke filluar nga zona e Krasit, për të dëshmuar që ne jemi korrektë, ndjekim çdo shqetësim dhe e kemi të gjithë vëmendjen që qytetarët, në radhë të parë të Krujës dhe Fushë- Krujës, por padyshim edhe të Tiranës që ndikohet nga ai krim mjedisor.

Në kuadër të realizimit të gjithçkaje çfarë themi, brenda sezonit të mbjelljeve të këtij viti, do të fillojmë rehabilitimin e plotë të malit të Krujës për ta shndërruar atë në një zonë të gjelbër turistike dhe, në fund të fundit, simbolin e turizmit shqiptar.

Eduard Shalsi – Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Zoti Ministër, unë kam një pyetje konkrete.

Kur do ta shpëtojë Fieri nga tymi dhe era e keqe e plehrave që gjenden akoma në zonën e vjetër të tij?

Pavarësisht nga fjalët dhe lufta politike, ju duhet të ndërtoni sa më shpejt atë çfarë u keni premtuar fierakëve dhe qytetarëve të qarkut të Fierit, të cilët duhet të fillojnë ta shikojnë si të domosdoshëm ndërtimin nga bashkia e Fierit, Lushnjës, Roskovecit dhe Patosit.

Duke e parë në këtë këndvështrim, përveç naftës, ne duhet të fillojmë ta shikojmë Fierin si destinacion turistik, për shkak të vijës së gjatë bregdetare që ai ka, rreth 70 kilometra, dhe të mos e shikojmë si një vend të ndotur nga nafta dhe plehrat.

Së dyti, në momentin e mbjelljeve të pemëve, mendoj që në zonat ku janë prerë pemë për hir të ndërtimit turistik, të mbillen pemë të tjera. Njëkohësisht, të shikoni mundësinë që të gjitha qytetet kryesore, sidomos të zonës fushore, për shkak të dëmtimit të pyjeve të fillojmë të mendojmë njësoj si Tirana për të ndërtuar një park ku të shkojnë të gjithë njerëzit. Bashkia e Fierit më duket se e ka një mendim të tillë dhe ka bashkëpunuar me ju, kështu që ndërtimi i tij do të ishte një gjë shumë e mirë.

Ju faleminderit!

Blendi Klosi – I nderuar koleg, besoj se jeni njohur me buxhetin e investimeve në kuadrin e infrastrukturës së mbetjeve urbane, e cila është pjesë e politikave që ndjek Ministria e Infrastrukturës si investim i drejtpërdrejtë në infrastrukturën e mbetjeve urbane. Unë u shpreha për vend-depozitimet ilegale, ku Fieri është pjesë. Në fakt, ato i kanë pasur komunat dhe bashkitë e vogla, që tani janë bashkuar. Mbyllja e tyre do të eliminojë të gjithë aktorët e tjerë, që ndotin shtratin e lumenjve dhe zonat jashtë bashkisë, për të shkuar në investimin e

plotë me ndërtimit e insineratorit në zonën e Fierit, i cili do të japë një zgjidhje përfundimtare jo vetëm për Fierin si bashki, por për të gjithë zonën. Shembujt si Tirana dhe Elbasani kanë dëshmuar që këto investime sjellin përmirësim të menjëhershëm të zonës për të cilën ne flasim.

Ndërtimi i landfillit në Vlorë dhe menaxhimi më i mirë i të teta zonave, që ne i kemi përcaktuar si zona rajonale të trajtimit të mbetjeve urbane, do të krijojë një situatë krejt tjetër me mbetjet urbane. Shpresojmë që, në kuadër të politikave që ndjek administrata qendrore dhe bashkitë, në rastin konkret Bashkia e Fierit bën një punë të shkëlqyer në këtë drejtim, ne të kemi ndërhyrje të menjëhershme.

Për sa u përket problematikave që ju ngritët në kuadër të mbjelljeve, një nga dimensionet më të forta të projektit është plotësimi i detyrimeve që kanë kompanitë që bëjnë investime të mëdha apo të vogla. Ne kemi një listë shumë të fortë, ku do të kërkojmë zbatimin e legjislacionit. Kështu që, çdo ndërmarrje që për hir të investimit pret një pemë, sipas ligjit shqiptar duhet të mbjellë tre të tjera. Në kuadër të detyrimeve që kanë kompanitë, ne do të realizojmë një pjesë shumë të madhe të shifrës prej 20 milionë pemë që duhet të mbillen në vendin tonë brenda vitit 2020.

I nderuar koleg deputetë, nesër unë do të jem në zonën e Patosit ku, në zbatim të detyrimit që kanë kompanitë e naftës të asaj zone për të rehabilituar zonat mjedisore, do të mbjellim disa mijëra pemë me të rinjtë e qytetit të Patosit, kjo në kuadër të gjithë fushatës sonë për mbjelljen e shumë më shumë pemëve në vendin tonë.

“Krijo oksigjenin tënd” nuk është një politikë që mund të realizohet vetëm nga aksione vullnetarësh, por duhet të kemi më shumë shoqërinë të përfshirë në mbjelljen e pemëve. Sezoni i mbjelljeve nëntor – prill 2018-2019 do të jetë për ne një moment kërkesë për ta shndërruar Shqipërinë në një shoqëri, e cila e do natyrën. Në qoftë se ne realizojmë një projekt shumë të madh që kemi me Ministrinë e Arsimit, që çdo zonë e mbrojtur të ketë një zonë të caktuar ku të rinjtë të krijojnë pyllin e tyre, oksigjenin e tyre, ne mund t’ia dalim të krijojmë zona kreative shumë të mira.

Kur fola për pemët, nuk e kisha fjalën vetëm për mbjelljet në pyje, por mbjelljen e pemëve dekorative, të frutikulturës, pemët që mbrojnë nga erozioni fshatrat buzë lumenjve, pemët që prodhojnë ekonomi dhe që ndihmojnë ekonominë e drejtpërdrejt të familjes fshatare dhe qytetare në vendin tonë.

Parku i Fierit është shumë i bukur. Ne e kemi projektin me bashkinë e Fierit, pasi ajo hyn në zonën e mbrojtur nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Mendoj që kemi

një dakordësi me bashkinë dhe zonat e mbrojtura që ai të jetë një park rekreativ për qytetin, sepse realisht është shumë i bukur.

Eduard Shalsi – Meqenëse po diskutojmë për pyjet, me ligjin e pyjeve çfarë bëhet?

Blendi Klosi – Shumë faleminderit!

Në datën 24 nëntor komisioni juaj do të marrë një ftesë nga ministria për të paraqitur në një konferencë kombëtare një material politikash për të gjithë sektorin e pyjeve. Materiali i politikave paraqet katër dimensione.

Dimensioni i parë është për mbjelljen dhe involvimin e shoqërisë në mbjelljen e pemëve.

Dimensioni i dytë është reformimi institucional që ne duhet të ndërmarrim për sa i përket sektorit të pyjeve. Ajo çfarë paraqitet në kuadër të reformimit të sektorit të gjithë institucioneve që janë në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është krijimi i një institucioni të ri për menaxhimin e politikave të pyjeve duke e kuptuar që tani pyjet kanë kaluar pronë e pushtetit lokal, por nuk ka një institucion që merret me politikat qendrore.

Po ashtu, vendosjen e një raporti më të fortë midis Inspektoratit të Pyjeve dhe Policisë së Shtetit, në mënyrë që Policia e Shtetit të jetë më e involvuar në mbrojtjen e territorit apo mbrojtjen e paligjshmërisë në sektorin e pyjeve.

Grupi i tretë i asaj çfarë ne do të paraqesim në dokumentin e politikave për pyjet është sektori i legjislacionit të ri. Ne kemi një draft, i cili, pa kaluar në institucionet shtetërore, do të vijë si diskutim me kolegët parlamentarë për të dhënë edhe ata mendimin e tyre. Një ligj i ri është shumë i nevojshëm pasi, siç e thashë, pyjet kanë pësuar shumë lëvizje duke mos u konsideruar asnjëherë si një sektor ekonomik. Për ne mbjellja e pemëve dhe lidhja e tyre me turizmin, natyrën, ekonominë, mbrojtjen nga erozioni dhe gjithë gjërat e tjera është një politikë shumë e rëndësishme.

Pra, të nderuar kolegë, shumë shpejt ne do të kemi draftin e parë të ligjit të ri për pyjet, i cili që në filluesën e vet mendojmë dhe dëshiroj të jetë pjesë e diskutimeve në këtë komision.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Po, Beqaj.

Ilir Beqaj – E mora fjalën për të shmangur ndonjë provokim që mund të më bëni ju si kolegë, sepse sot nuk kam për të bërë asnjë pyetje. Kjo për faktin se Shqipëria arriti të ketë 6 milionë turistë. Kishim vite që flisnim, por qeset plastike tani i ndaluam dhe thamë që do përdoren vetëm qese të riciklueshme. Kemi 20 vjet që flasim, por tani u vendos që nga 1 janari makinat nuk do të jenë më shumë se dhjetë vjet ...

Komplimente, zoti Ministër! Sukseset flasin vetë. Nëse duhet mbështetje për gjëra të tjera, këtu jemi dhe mund t'i diskutojmë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Kjo paska qenë arsyeja pse nuk doje t'ia jepje fjalën.

Ministri do kritika, jo komplimente.

Ka ndonjë merak ndonjë koleg tjetër?

Duke ju uruar punë të mbarë, do të vijojmë të jemi në kontakt me ministrinë për të ndjekur me kërshtëri zhvillimet në mjedis dhe turizëm.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA